REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1252/1 prot. Tiranë, më 29.9.2026

V E N D I M
Nr. 35, datë 29.9.2026

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 29.9.2026,

V E N D O S I:

I. Të bëhen disa shtesa e ndryshime në nenet 41, 42 dhe 43, si dhe në Anekset 7, 10 dhe 10/2, në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin nr.1, datë 31.1.2017, i ndryshuar,

1. **Në nenin 41 "Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë dhe avokatë shteti në përfundim të vitit të dytë",** në titull të hiqet togfjalëshi "dhe avokatë shteti" dhe në pikën 3, në fund të paragrafit të shtohet togfjalëshi "me cilësinë e anëtarit vëzhgues".

2. **Pas nenit 41 shtohet neni 41/a me këtë përmbajtje:**

Neni 41/a
Vlerësimi i kandidatëve për avokatë shteti në përfundim të vitit të dytë

1. *Në fund të vitit të dytë organizohet provimi përfundimtar, i cili bëhet me shkrim, me dy raste praktike nga fushat e mëposhtme:*

a. *pjesa e parë - E drejta private (civile, familjare, e punës, tregtare) dhe e drejta procedurale civile;*
b. *pjesa e dytë - E drejta publike (E drejta administrative materiale dhe e drejta procedurale administrative; e drejta kushtetuese, të drejtat e njeriut, e drejta ndërkombëtare dhe e BE-së).*

2. *Provimi përfundimtar vlerësohet nga një komision i përbërë nga tre anëtarë, nga të cilët*
   dy anëtarë nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës dhe një anëtar nga Avokatura e Shtetit, me cilësinë e anëtarit vëzhgues.
3. *Rregullat më të detajuara lidhur me provimin përfundimtar, si dhe mënyrën e vlerësimit të tij janë të parashikuara në Aneksin 10 të kësaj Rregulloreje.*
4. *Vlerësimi përfundimtar për të dy vitet bëhet nga Këshilli Pedagogjik, sipas mënyrës dhe rregullave të përcaktuara në Aneksin 10 të kësaj Rregulloreje. Të gjitha të dhënat pasqyrohen në SMVSHM dhe administrohen në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale."*

3. **Në nenin 42 "Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për magjistratë dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit":**

a) Në titull të hiqet togfjalëshi "dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit";
b) Në përmbajtje të hiqen pikat 2, 3 dhe 5, dhe ky nen të ketë këtë përmbajtje:

Neni 42

"Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për magjistratë"

1. *Në fund të stazhit profesional, Këshilli Pedagogjik bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë, në bazë të rezultateve të vlerësimit të lëndëve të vitit të parë, të stazhit paraprofesional dhe të provimit përfundimtar, sipas sistemit me 5 shkallë, mbi bazën e një renditje përfundimtare të tyre me pikë.*
2. *Drejtori i Shkollës i përcjell Këshillit Drejtues të Shkollës, Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët për gjyqtarë, si dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për kandidatët për prokurorë vendimin e Këshillit Pedagogjik, ku janë bashkuar sipas një renditjeje me pikë vlerësimet me 5 shkallë të dy viteve të para, të provimit përfundimtar dhe të praktikës profesionale të vitit të tretë.*
3. *Rregulla më të detajuara lidhur me mënyrën e vlerësimit, kriteret si dhe koeficientet e vlerësimit parashikohen në planin mësimor dhe Aneksin 10 të kësaj Rregulloreje.*
4. *Vlerësimet e kandidatëve në të gjitha fazat e programit mësimor janë të aksesueshme nëpërmjet SMVSHM-së dhe administrohen në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale."*

4. **Pas nenit 42 të shtohet neni 42/a me këtë përmbajtje:**

Neni 42/a

Vlerësimi përfundimtar për pozicionet në Avokaturën e Shtetit

1. *Në fund të vitit të dytë, Këshilli Pedagogjik bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për pozicionet në Avokaturën e Shtetit, në bazë të rezultateve të lëndëve të vitit të parë, të stazhit paraprofesional dhe të provimit përfundimtar, sipas sistemit me 5 shkallë, mbi bazën e një renditje përfundimtare të tyre me pikë.*
2. *Drejtori i Shkollës i përcjell Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit vendimin e Këshillit Drejtues, për vlerësimin përfundimtar sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij neni.*
3. *Rregulla më të detajuara lidhur me mënyrën e vlerësimit, kriteret si dhe koeficientet e vlerësimit parashikohen në Aneksin 10 të kësaj Rregulloreje.*
   Vlerësimet e kandidatëve në të gjitha fazat e programit mësimor janë të aksesueshme nëpërmjet SMVSHM-së dhe administrohen në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale."

5. Në **nenin 43 "Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltarë ligjorë dhe ndihmës ligjorë në gjykata dhe prokurori si dhe prokurorinë e posaçme,** të hiqet pika 3 dhe ky nen të ketë këtë përmbajtje:

Neni 43

Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltarë ligjorë dhe ndihmës ligjorë në gjykata dhe prokurori si dhe prokurorinë e posaçme

1. *Në përfundim të Programit të Formimit Fillestar 1-vjeçar për këshilltarë ligjorë dhe ndihmës ligjorë, Shkolla organizon provimin përfundimtar. Kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të pikëve totale në provimin përfundimtar, vlerësohen se kanë përfunduar me sukses Programin e Formimit Fillestar."*
2. *Rregullat e organizimit të provimit përfundimtar të kandidatëve për magjistratë zbatohen, për aq sa ato janë të përshtatshme, edhe për këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit ligjorë.*
3. *Lista e kandidatëve fitues miratohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, publikohet në faqen zyrtare të saj dhe i paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe/ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë për emërim.*
4. *Lista e kandidatëve fitues të paemëruar ende është e vlefshme për një periudhë katërvjeçare nga shpallja e fituesve.*
5. *Vlerësimet e kandidatëve në të gjitha fazat e programit mësimor janë të aksesueshme nëpërmjet SMVSHM-së dhe administrohen në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale."*

6. Në aneksin 7 "Marrëveshja e regjistrimit për kandidatët për magjistratë" të bëhen disa përmirësime gjuhësore në përmbajtjen e aneksit dhe të zëvendësohet koncepti i provimit me atë të vlerësimit, si më poshtë:

a) Në nenin 4, pika "b" të hiqet fjala *provim* dhe të zëvendësohet me fjalën *vlerësim*: me këtë përmbajtje: "*Marrja pjesë në çdo vlerësim me shkrim që zhvillohet përgjatë lëndës në datën e caktuar nga Shkolla e Magjistraturës për kandidatët e këtij viti akademik, është e detyrueshme, përveçse në rastet kur paraqiten arsye të përligjura dhe objektive. Vlerësimi në këto raste, për efekt të ruajtjes së sekretimit, kryhet me kandidatët e vitit pasardhës.*"

b) Në nenin 4, pika "c" të hiqet fjala *provim*, me këtë përmbajtje: "*Kandidati për magjistrat duhet të plotësojë të gjitha detyrimet që lindin nga zbatimi i programit dhe planit mësimor, si në procesin e përbashkët, ashtu dhe në atë individual të kualifikimit. Vlerësimi "pamjaftueshëm" i marrë dy herë radhazi, të paktën në dy lëndë ose në provimin me raste praktike, passjell, sipas rastit, humbjen e të drejtës për vijimin e programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.*"

c) Në nenin 4, pika "d" të hiqet fjala *provim* dhe të zëvendësohet me fjalën *vlerësim*, me këtë përmbajtje: "*Kandidatët nuk kanë të drejtë të rivlerësohen për lëndën, me qëllim përmirësimin e rezultateve. Vetëm në raste tepër të veçanta, që diktohen nga rrethanat dhe për arsye objektivisht të përligjura, kandidati mund të vlerësohet në vitin pasardhës, pasi të ketë marrë më parë miratimin e Këshillit Pedagogjik të Shkollës.*"

7. Në aneksin 10, "Për vlerësimet e kandidatëve për magjistratë në Formimin Fillestar", në pjesën V "Vlerësimi në vitin e dytë", komponenti B/3, të shtohet togfjalëshi "është anonim" dhe "arsyetimin e vlerësimit", sipas përmbajtjes më poshtë:

"3) *Mënyra e vlerësimit të praktikës përmes dosjeve (portofolit) të kandidatit*
3.1 Vlerësimi i dosjes së kandidatit do të jetë me 100 pikë, me koeficient vështirësie 2.15 dhe do të bëhet nga pedagogët e brendshëm përgjegjës dhe pedagogët e lëndëve përkatëse.
3.2. Ky vlerësim *është anonim* dhe realizohet nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me urdhër të Drejtorit. Komisioni përbëhet nga, të paktën, dy pedagogë.
3.3. Çdo dosje duhet të vlerësohet në tërësinë e saj nga secili nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit në mënyrë të pavarur.
3.4. Pas korrigjimit të pavarur të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, ata kryejnë së bashku, në mjediset e Shkollës, verifikimin në mënyrë të kryqëzuar të rezultateve dhe nxjerrin bashkërisht rezultatin final të vlerësimit *dhe arsyetimin e vlerësimit*.
3.5. Vlerësimi i dosjes së kandidatëve bëhet në një procesverbal përfundimtar të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit."

8. Aneksi 10/2, "Për vlerësimin e kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë gjatë Programit të Formimit Fillestar", të ketë këtë përmbajtje:

"I. Vlerësimi i kandidatëve gjatë Programit të Formimit Fillestar

1. Programi i Formimit Fillestar, për kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, shtrihet në *një vit akademik*, ku kandidatët do të vlerësohen hap pas hapi dhe do të kenë rezultatet përfundimtare në përfundim të këtij viti akademik.

2. Parimet dhe kriteret e vlerësimit parashikohen në këtë Rregullore. Skema dhe komponentët e vlerësimit miratohen çdo vit nga Këshilli Drejtues si pjesë e planit mësimor dhe programit të lëndëve."

"II. Vlerësimi në Programin e Formimit Fillestar

1. Plani mësimor i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë është i përshtatur me aftësitë dhe kompetencat që lidhen me profesionin e ardhshëm të këtyre subjekteve të trajnimit. Ky program ka karakter *kryesisht* praktik ku kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë *zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë* në fusha të ndryshme të së drejtës
2. Vlerësimi i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë bëhet bazuar në veprimtaritë e tyre në Shkollë dhe në vendet ku janë caktuar për të zhvilluar praktikë mësimore, sipas planit mësimor.
3. Kandidatët vlerësohen bazuar në tre komponentë bazë:
   a) Aftësitë dhe kompetencat ligjore;
   b) Aftësitë dhe kompetencat joligjore ("soft skills");
   c) Provim *përfundimtar*.
4. Vlerësimi i dy komponentëve të parë, "a" dhe "b", realizohet përgjatë gjithë vitit akademik dhe ka karakter progresiv. Këto komponentë vlerësohen si në veprimtaritë në Shkollë, edhe në veprimtaritë në praktikën mësimore, sipas planit mësimor. Vlerësimi i provimit përfundimtar bëhet në përfundim të programit, sipas ndarjes III në vijim-dhe planit mësimor.

III. Vlerësimi i provimit me rastet praktike

1. Provimi me rastet praktike, i cili do të zhvillohet pasi të kenë përfunduar vlerësimet e secilës lëndë, do t'i nënshtrohen ata kandidatë të cilët kanë arritur të vlerësohen të paktën "mjaftueshëm" në vlerësimin përfundimtar të secilës lëndë.
2. *Përmbajtja e provimit dhe përbërja e komisionit të vlerësimit të provimit bëhet në përputhje me planin mësimor të miratuar, bazuar edhe në profilin që kanë kandidatët në formimin fillestar. Në çdo rast, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit do të ketë pedagogë të brendshëm dhe/ose të jashtëm të Shkollës, anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe/ose anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në cilësinë e anëtarit vëzhgues.*
3. Provimi me rastet praktike bëhet me shkrim dhe i nënshtrohet procesit të sekretimit, me qëllim ruajtjen e objektivitetit.
4. Gjatë provimit, të gjithë kandidatëve do t'u shpërndahet një zarf i vogël, i cili brenda ka një letër në të cilën do të shkruhet emri i kandidatit për magjistrat. Zarfi i vogël nuk duhet të mbyllet deri në momentin e dorëzimit të provimit. Mbyllja e tij do të bëhet në fund e do të vuloset nga personi përgjegjës i caktuar. Zarfi i madh do të mbyllet nga kandidati dhe duhet të ketë brenda vetëm përgjigjet. Zarfi do të vuloset nga personi përgjegjës. Përmbajtja e çdo zarfi është në përgjegjësinë e kandidatit

përkatës. Tezat që mungojnë në zarf vlerësohen nga Komisioni me 0 pikë. Anëtari i Komisionit që konstaton i pari mungesën e tezës në zarf e bën këtë gjë publike duke mbajtur një procesverbal të veçantë për këto mungesa, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Emri nuk do të shkruhet në asnjë nga fletët e provimit. Nuk shkruhet mbi vulë. Mbi çdo zarf vendosen 2 (dy) vula. Sipërfaqja e zënë nga vula duhet të jetë gjysma mbi fundin e kapakut të zarfit dhe gjysma mbi pjesën e poshtme të zarfit, që ndodhet menjëherë pas kapakut të zarfit. Nuk duhet të lihen hapësira boshe midis rreshtave dhe nuk duhet të përdoren mjete të tjera (fletë, stilolapsa), veç atyre të dhëna nga Shkolla.

5. Kandidatët nuk lejohen të mbajnë shalle apo kapele, syze dielli, gjatë procesit të provimit. Ndalohet përdorimi dhe mbajtja e telefonave celularë si dhe e pajisjeve të tjera. Kandidatët nuk duhet të flasin ose të japin e marrin asistencë nga njëri-tjetri apo nga të tjerë gjatë provimit, për asnjë lloj arsyeje.
6. Pasi përfundon provimi, do të bëhet përzgjedhja e zarfeve të provimit në prani të kandidatëve, pastaj do të bëhet sekretimi i tyre. Pas dorëzimit të fletëve të provimit, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës do të vendosë numrin, si në zarfin e vogël, ashtu dhe në zarfin e madh të çdo kandidati. Komisionit të provimit do t'i vihet në dispozicion vetëm zarfi i madh, me numrin përkatës, i cili përmban fletët e provimit.
7. Zarfet e mëdha me fletët e përgjigjeve do të hapen vetëm në ditët e korrigjimit në prani të komisionit të korrigjimit. Pasi të shpallen rezultatet në bazë të numrave të sekretimit, hapja e zarfeve të vegjël me emrat do të bëhet pas një jave në prani të kandidatëve për magjistratë, në mjediset e Shkollës së Magjistraturës.
8. *Pas shpalljes së rezultatit të provimit nuk* ka seancë ballafaqimi direkt me komisionin e vlerësimit.
9. Provimi me rastet praktike vlerësohet *me 150 pikë*, me koeficient vështirësie 2.
10. Kandidatët nuk kanë të drejtë të rivlerësohen për lëndën me qëllim përmirësimin e rezultateve.
11. Vetëm në raste tepër të veçanta, që diktohen nga rrethanat dhe për arsye objektivisht të përligjura, kandidati mund të vlerësohet në vitin pasardhës, pasi të ketë marrë më parë miratimin e Këshillit Pedagogjik të Shkollës.
12. Vlerësimi "pamjaftueshëm" i marrë dy herë radhazi, të paktën në dy lëndë dhe në vlerësimin e përgjithshëm, të provimit përfundimtar, sjell, sipas rastit, humbjen e së drejtës për vijimin e studimeve në Shkollën e Magjistraturës."

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.